

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare

Oda Ekonomike e Kosovës

Më dhe për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	2
Pasqyra e pozitës financiare	4
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Shënimet e pasqyrave financiare	8

Raporti i auditorit të pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10 000 Pristina
Kosovo

T +381 38 247 771
+381 38 247 801
F +381 38 247 802
www.grantthornton-ks.com

Për menaxhmentin e
Oda Ekonomike e Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Oda Ekonomike e Kosovës (më tutje referuar si “OEK” apo Organizata), që përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar deri më 31 dhjetor 2015 pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyra e ndyshimeve në fonde dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe përmbledhjen e politikave kryesore kontabël dhe shënimet tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël siç janë shpalosur në Shënimin 2 të pasqyrave financiare, dhe për kontrollin e brendshme siç përcakton menaxhmenti, është e nevojshme të mundësojë përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë si pasojë e mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave për të siguruar prova në lidhje me shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimet e rreziqeve për gabimet materiale në pasqyra financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që bëhen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që ne kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat e opinionit tonë të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Oda Ekonomike e Kosovës më 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe rrjedhën e sajë të parasë për vitin e përfunduar në përputhshmëri me politikat dhe procedurat e kontabilitetit të paraqitura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare shoqëruese.

Ky raport është përkthim jozyrtar i versionit origjinal në anglisht, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
16 nëntor 2016

Pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2015

Pasqyra e pozitës financiare

Shënimet	Më 31 dhjetor 2015 (në 000 EUR)	Më 31 dhjetor 2014 (në 000 EUR)
ASETET		
Asetet jo-qarkulluese		
Prona, impiantet dhe pajisjet	5	1,063
	1,063	1,112
Asetet qarkulluese		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	6	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	128
	128	166
Gjithsej asetet	1,191	1,278
FONDET E AKUMULUARA DHE DETYRIMET		
Fondet e akumuluar		
Më 1 janar	1,031	1,152
Neto (deficiti) I vitit	(13)	(121)
Rezervat e rivlerësimit	82	82
	1,100	1,113
Detyrimet		
Detyrimet jo-qarkulluese		
Huamarrjet	8	5
	5	13
Detyrimet qarkulluese		
Huamarrjet	8	8
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	9	78
	86	152
Gjithsej detyrimet	91	165
Gjithsej fondet e akumuluar dhe detyrimet	1,191	1,278

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti më 4 nëntor 2016, dhe janë nënshkruar në emër të:

Parim Bajrami
Sekretar Gjeneral

Ibrahim Beqiri
Drejtore Financiar

Pasqyrat financiare
31 Dhjetor 2015

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Shënimet	Për vitine përfunduar më	
	31 dhjetor 2015 (në 000 EURO)	31 dhjetor 2014 (në 000 EURO)
Të hyrat		
Të hyrat nga anëtarësimi	177	206
Të hyrat nga shërbimet dhe aktivitetet	10 622	638
Të hyrat nga grantet	11 83	64
Gjithsej të hyrat	882	908
Shpenzimet		
Zhvlerësimi	5 (49)	(101)
Shpenzimet e stafit	12 (353)	(339)
Shpenzimet operative	13 (491)	(586)
(Deficiti) para shpenzimit të interesit	(11)	(118)
Shpenzimi i interesit	(2)	(3)
	(2)	(3)
(Deficiti) i vitit	(13)	(121)
Të hyra të tjera gjithëpërfshirëse	-	82
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin	(13)	(39)

Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2015

Pasqyra e ndryshimeve në fonde

	Rezervat e rivlerësimit	Shumat në 000 EURO	
		Bilanci I fondeve	Gjithsej Bilanci I fondeve
Më 1 janar 2015	82	1,031	1,113
<i>Transaksionet me pronarët</i>	-	-	-
Teprica/(deficiti) i vitit	-	(13)	(13)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
<i>Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse</i>	-	(13)	(13)
Më 31 dhjetor 2015	82	1,018	1,100
Më 1 janar 2014	-	1,152	1,152
<i>Transaksionet me pronarët</i>	-	-	-
Teprica/(deficiti) i vitit	-	(121)	(121)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse (Shënimi 5)	82	-	82
<i>Gjithsej të ardhurat gjithpërfshirëse</i>	82	(121)	(39)
Më 31 dhjetor 2014	82	1,031	1,113

Pasqyrat financiare
31 dhjetor 2015

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Shënimet	Për vitin e përfunduar më	
		2015 (në 000 EURO)	2014 (në 000 EURO)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative (Deficiti) për vitin		(13)	(121)
Rregullime për:			
Zhvlerësimi	5	49	101
Shlyerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	5	-	25
Provizioni për të arkëtueshmet	13	77	49
Shpenzimet e interesit		2	3
<i>Të ardhurat operative para ndryshimeve në kapital</i>		115	57
Ndryshime në të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera		(25)	75
Ndryshime në të pagueshmet tregtare dhe të tjera		(67)	(40)
		23	92
Interesi i paguar		(2)	(3)
Paraja e gatshme neto (e përdorur) në aktivitete operative		21	89
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		-	-
Paraja e gatshme neto (e përdorur) në aktivitete investive		-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare (Ripagimi) i / procedime nga huamarrjet		(7)	(7)
Paraja e gatshme neto (e përdorur) në aktivitete financiare		(7)	(7)
Neto ndryshimi në paranë dhe ekuivalentët e saj		14	82
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		114	32
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	128	114

Shënimet e pasqyrave financiare

1 E përgjithshme

Oda Ekonomike e Kosovës (“OEK”) është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962. OEK është organizatë profesionale e pavarur, jopolitike dhe jofitimprurëse. Është institucioni i themeluar me ligj dhe veprimtaria e OEK-ut zhvillohet mbi bazën e këtij Ligji (Ligji mbi Odën Ekonomike të Kosovës 2004/7 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. OEK është e regjistruar dhe e njohur me numër fiskal 600181888.

OEK është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike. Oda Ekonomike e Kosovës analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare.

OEK kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjeve dhe me profesionalizimin dhe vendosmërinë e saj kontribuon në përafrimin e biznesit kosovar dhe shoqërisë kosovare me vlerat evropiane.

Oda Ekonomike e Kosovës përbëhet nga këto departamente:

- Analizat ekonomike dhe dialogjet sociale,
- Politikat biznesore dhe promocionet,
- Tregëtia ndërkombëtare, investimet dhe marketingu,
- Zhvillimi i biznesit dhe menaxhmenti i kompanisë

OEK përveç selisë qendrore të Prishtinës ka dhe disa njësi regjionale si atë të Mitrovicës, Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Gjilanit dhe Ferizajit.

Në bazë të Ligjit mbi OEK-un, anëtarësimi në OEK është vullnetar, anëtar i Odës Ekonomike të Kosovës konsiderohet subjekti juridik apo fizik që nënshkruan Marrëveshjen për Anëtarësim dhe i kryen të gjitha obligimet sipas kësaj marrëveshjeje. Ekzistojnë disa nivele të anëtarësimit në OEK si niveli bazë, niveli i mesëm, niveli i lartë dhe patron. Pas anëtarësimit, OEK luan rolin si përfaqësuese, lobuese, mbrojtëse e interesave të komunitetit të biznesit dhe ofruese e shërbimeve publike e profesionale.

OEK-u ka autorizime publike për:

- Të ofruar shërbimin e Arbitrazhit të Përhershëm për zgjedhjen e kontesteve ekonomike dhe juridike;
- Lëshimin e Çertifikatave të Originës;
- Lëshimin e Çertifikatave në fushën e Transportit Rrugor (CPC dhe ADR)

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)**E përgjithshme (vazhdim)****Shërbimet gjenerale të OEK janë:**

Përfaqësimi i interesave të Komunitetit të Biznesit brenda dhe jashtë Kosovës, përfaqësimi i interesave të punëdhënësve në dialogun social, promovimi i imazhit të Kosovës dhe i mundësive për investime në Kosovë, organizimi i misioneve tregtare, takimeve B2B në mes të ndërmarrjeve kosovare dhe të huaja dhe vizita në panairët më të rëndësishme ndërkombëtare,

Shërbimet promovuese:

Panairë, Klube Biznesi dhe promovimi i kompanive në aktivitete të organizuara me grupe të fokusuara të ndërmarrjeve, konsulence, lëshimi i barkodeve për produkte kosovare, përgatitje të ndërmarrjeve për Çertifikim me ISO;

Trajnimet:

Trajnime në fushën e transportit – CPC dhe ADR, trajnime të nivelit ekzekutiv, të organizuara në bashkëpunim me WIFI, trajnime në fushën e aftësisë dhe arsimit profesional me përkrahje të Komisionit Evropian.

Zyra qendrore është e vendosur në adresën e mëposhtme: Nëna Tereza Nr. 20, Prishtinë, Kosovë. Më 31 dhjetor 2015 organizata ka 48 të punësuar (31 dhjetor 2014: 48 të punësuar).

2 Politikat kontabël

Politikat kontabël kryesore të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë detajuar si më poshtë.

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën parimin e kostos historike dhe të vijshmerisë.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kritike kontabël që kanë të bëjnë me shumat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve, shpalosjen e aseteve dhe detyrimeve kontigjente në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe me shumat e të hyrave dhe shpenzimeve gjatë kësaj periudhe. Këto vlerësime janë të bazuara në informacionet e gatshme në datën e pasqyrave financiare dhe rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur më dhe për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 dhe 2014. Të gjitha shumat janë shprehur në mijëra Euro (000 Euro) përveç nëse është cekur ndryshe.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Artikujt e përfshirë në pasqyrat financiare janë matur duke përdorur valutën e hapësirës primare ekonomike në të cilën operon Organizata (“monedha funksionale”). Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Euro, që është valuta funksionale dhe e prezentuar e OEK.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave dhe vlerat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve (referohu në Shënimin 3).

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë të ndryshëm që besohet të jenë të arsyeshëm në rrethanat, rezultatet e të cilave formojnë bazën e bërjes së gjykimeve për vlerat bartëse të aseteve dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të dukshëm nga burimet tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet themelore janë rishikuar në bazë të vazhdueshme. Inspektimet e vlerësimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhen në të cilën janë rishikuar, nëse inspektimi ndikon vetëm në atë periudhë ose në periudhën e inspektimit dhe periudhat e ardhshme nëse inspektimi ndikon periudhat e tanishme dhe të ardhme.

2.4 Prona, impiantët dhe paisjet

Ndërtesat e OEK janë njohur me vlerën e rivlerësimit minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi-nëse ka, kurse makinat dhe pajisjet tjera janë njohur me vlerën minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi-nëse ka.

Shumat e rivlerësuara janë vlera reale të tregut bazuar në vlerësimeve të përgatitura nga vlerësues të jashtëm profesional me 31 dhjetor 2014. Çdo suficit nga rivlerësimi njihet në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse dhe kreditohet në rezervat e rivlerësimit në ekuitet.

Për aq sa çdo rënie apo humbje nga rivlerësimi është njohur më parë në fitim apo humbje, një rritje nga rivlerësimi kreditohet në fitim apo humbje me pjesën e mbetur të rritjes së njohur në të hyrat tjera gjithëpërfshirëse. Rivlerësimet në rënie të pronës, impiantëve dhe pajisjeve njihen në testim të vlerësimit apo zhvlerësimit, ku rënia hyn tek të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse për aq sa është suficiti në ekuitet lidhur me këtë aset dhe pjesës tjetër së rënë të mbetur e njohur në fitim apo humbje. Çdo suficit nga rivlerësimi i mbetur në kapital në dispozicion të asetit është transferuar në fitimet e mbajtura.

Kostoja historike përfshin shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e asetit. Kosto e aseteve të ndërtuara vetë përfshijn koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt për të sjellë pasuritë në gjendjen funksionale për përdorimin e tyre të synuar, kostot e çmontimit dhe heqjes së artikullit dhe rregullimin e vendit në të cilin ata janë të vendosura, janë shpenzime të huave të kapitalizuara për asetet kualifikuese.

Blerjet e mëvonshme janë të përfshira në asetet që bartin vlerë ose njihen si aset i vecantë, respektivisht, vetëm kur ka mundësi për të ardhura në perfitimet ekonomike të OEK në të ardhmen lidhur me asetin, dhe kur vlera e koston së asetit mund të matet në mënyrë të arsyeshme. Të gjitha mirëmbajtjet dhe riparimet tjera njihen si shpenzime në pasqyrat e të hyrave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Zhvlerësimi i pronës, impiantit dhe paisjeve është llogaritur duke përdorur metodën e salldos zbritëse për të alokuar koston tek vlera e mbetur përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar, si në vazhdim.

Ndërtesat	30 Vite
Makinat dhe paisjet tjera	5 Vite

Jeta e përdorimit dhe vlera e mbetur e aseteve janë rishikuar, dhe rregulluar në çdo pasqyrë të pozicionit financiar nëse ka genë e nevojshme.

Fitimet dhe humbjet nga heqja prej përdorimit përcaktohen duke krahasuar të hyrat me vlerën e bartur. Këto përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.5 Asetet financiare

OEK klasifikon asetet e saj financiare në këto kategori: hua dhe të arkëtueshme. Ky klasifikim varet nga qëllimi për të cilin janë blerë asetet. Menaxhmenti vendos klasifikimin e investimit të tyre në njohjen fillestare dhe rivlerëson atë në çdo datë të raportimit.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv përveç atyre asetve që OEK pretendon ti shes në periudhë afatshkurt ose që janë caktuar me vlerë të drejtë përmes profitit ose humbjes, ose aseteve të gatshme për shitje. Huatë dhe të arkëtueshmet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionin për efekt zhvlerësimi. Provizioni për dëmin e huave dhe llogarive të arkëtueshme është krijuar kur ka evidencë objektive që OEK nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumatat në përputhje me termat e tyre origjinale.

Matja e mëpasshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.6 Humbje nga zhvlerësimi

Asetet financiare të bartura në kosto të amortizimit

OEK e vlerëson në secilën datë të pozicionit financiar nëse ka dëshmi objektive se një aset apo tërësi e aseteve financiare ka humbur vlerë. Një aset apo tërësi e aseteve financiare humbet vlerë dhe humbjet e dëmtimit janë ndodhur vetëm nëse ka dëshmi objektive të dëmtimit si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të asetit (një ngjarje e humbjes) dhe se ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) kanë ndikim i cili mund të matet besueshëm në rrjedhën e parasë së vlerësuar për të ardhmen e asetit financiar apo grup të aseteve financiare.

Dëshmia objektive se një aset financiar apo asetet e organizatës janë dëmtuar përfshinë të dhënat e dallueshme që tërheqin vëmendjen e OEK mbi ngjarjet në vazhdim:

- Vështirësi e dukshme financiare e emetuesit apo debitorit;
- Shkelja e kontratës, si vonesat e pagesave apo mospagesat;
- Është e mundur që emetuesi apo debitori do të hyjë në bankrotim apo riorganizim tjetër financiar;
- Mosparaqitja e një tregu aktiv për atë aset financiar për shkak të vështirësive financiare, apo
- Të dhënat e dukshme tregojnë se ka zvogëlim në parashikimin e ardhshëm të rrjedhës së parasë nga asetet financiare të kompanisë që nga njohja fillestare e këtyre aseteve, megjithëse zvogëlimi nuk mund të identifikohet akoma me asetet individuale në OEK, duke përfshirë:
 - Ndryshime jo të favorshme në statusin e pagesës të emetuesit ose borxhliut në grup; ose
 - Kushte ekonomike shtetërore ose vendore që ndërlidhen me problemet në asetet e grupit.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim) Politikat kontabël (vazhdim)

Humbjet nga zhvlerësimi (vazhdim)

OEK fillimisht vlerëson nëse dëshmia objektive mbi dëmtimin ekziston veçmas për asetet financiare që janë individualisht të rëndësishme. Nëse ka dëshmi objektive se ka ndodhur një humbje dëmtimi mbi kreditë dhe të arkëtueshmet apo investimet e mbajtura deri në maturim të bartura në kostot të amortizuar, shuma e humbjes është matur si ndryshim ndërmjet vlerës bartëse të asetit dhe vlerës aktuale të rrjedhave të vlersuara të parasë në të ardhmen (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kreditit që kanë ndodhur) të zbritura në normën origjinale dhe efektive të interesit të asetit financiar. Vlera bartëse e asetit është reduktuar përmes përdorimit të llogarisë për lejim, dhe shuma e humbjes është njohur në pasqyrën e të ardhurave. Nëse një investim i mbajtur deri në maturim apo hua ka normë variabël të interesit, norma e zbritjes për matjen e ndonjë humbje të dëmtimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar nën kontratë. Për të qenë më praktik, OEK mund të masë dëmtimet në bazë të vlerës reale të një instrumenti duke përdorur çmimin e dukshëm të tregut.

Nëse në një periudhë pasuese, shuma e humbjes së dëmtimit ulet dhe kjo ulje mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së dëmtimit (siç mund të jetë norma e përmirësuar e kredise), atëherë humbja e dëmtimit e njohur paraprakisht është kthyer duke rregulluar konton për lejim. Shuma e kthimit është njohur në fitim ose humbje.

2.7 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus provizionit për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësimin e të arkëtueshmeve tregtare krijohet kur ka evidencë objektive që OEK nuk do të jetë në gjendje të alokojë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve.

Vështirësi të konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do falimentojë ose riorganizimet financiare, si dhe mospagesa ose pagesat e parregullta konsiderohen si tregues se të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar. Debitorët e rëndësishëm individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Debitorët e mbetur vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kreditit.

Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës bartëse të asetit dhe vlera aktuale e vlerësimit të rrjedhës së parasë në të ardhmen, të zbritura në normën fillestare të interesit. Asetet me maturitet të shkurtër nuk zbriten. Vlera bartëse e asetit zbritet përmes përdorimit të një llogarie të kompensimit, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse. Kur një e arkëtueshme tregtare është jo e alokueshme, ajo shlyhet kundër provizionit të saj. Rikuperimet pasuese të shumave të shlyera më parë njihen si të hyra të tjera në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse.

2.8 Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshinë paranë në dorë dhe depozitat në bankat vendore me maturitet origjinal më pak se 3 muaj.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)

2.9 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, neto nga uljet dhe shitjet e lidhur me taksat.

Të hyrat njihen si në vijim:

Kryerja e shërbimeve

Shitjet e shërbimeve njihen në periudhën në të cilën shërbimet janë kryer, duke iu referuar fazës së përfundimit, kur mund të matet me besueshmëri. Faza e realizimit përcaktohet në bazë të sondazheve të punës së kryer.

Të hyrat financiare njihen në bazë përpjesëtimore me kohën që pasqyron interesin efektiv mbi asetet.

Shpenzimet financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit mbi huamarrjet dhe shpenzimet paracaktuara të interesit për pagesat e vonuara. Kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e të hyrave mbi përdorimin e shërbimit.

2.10 Fondet

Fondet krijohen fillimisht nga kontributet e themeluesve të bëra në asetet monetare dhe / ose në asetet e mbajtura me vlerat e tyre të drejta. Më pas, fondet janë rritur / ulur përmes kontributeve shtesë, të themeluesve, dhe rezultatet (teprica / deficieti) nga operacionet gjatë periudhave.

2.11 Detyrimet tregtare dhe të tjera

Detyrimet njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke aplikuar metodën e normës efektive të interesit.

2.12 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, neto nga kostot e transaksionit të bëra. Huazimet janë kryer më pas me koston e amortizuar; çdo diferencë midis të ardhurave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së riblerjes njihet në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse gjatë periudhës së huamarrjeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Tarifat e paguara për ngritjen e lehtësirave në marrjen e kredive njihen si kostot e transaksionit të kredisë në masën që është e mundur që disa ose e gjithë lehtësira kreditore do të tërhiqet poshtë. Në këtë rast, pagesa është shtyrë deri sa të ndodhë barazimi-ulja. Huamarrjet klasifikohen si detyrime aktuale përveç nëse OEK ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së deklaratës të pozicionit financiar.

2.13 Qiraja

Përcaktimi nëse një marrëveshje është, ose përmban një qira është i bazuar në thelbin e marrëveshjes në datën fillestare, pra, nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga: përdorimi i një aseti specifik, aseteve, ose nëse marrëveshja jep të drejtën për të përdorur pasuri.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Politikat kontabël (vazhdim)**Qiraja (vazhdim)**

OEK si qiramarrës

Qiratë financiare, të cilat i transferojnë OEK të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e sendit të marrë me qira, kapitalizohen në fillim të qirasë në vlerën e drejtë të mjeteve me qira dhe pajisjet, ose, me vlerë më të ulët, me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë.

Pagesat e qirasë ndahen në akuzat e financave dhe reduktim të detyrimit të qirasë në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit në bilancin e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare ngarkohen drejtpërdrejtë kundër të ardhurave. Në qoftë se nuk ka siguri të arsyeshme që OEK do të marrë pronësinë në fund të afatit të qirasë, asetet e kapitalizuara me qira zhvlerësohen për periudhën më të shkurtër të jetës së dobishme të asetit ose të afatit të qirasë.

Pagesat e dhënies me qira njihen si shpenzim në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Kosto që lidhen si mirëmbajtjes dhe sigurimit, njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

2.14 Përfitimet e punëtorëve***Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore***

OEK nuk kalkulon provizionim dhe nuk krijon obligime për pensionet e punëtorëve, përveç kontributeve të paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

2.15 Provizionet

Një provizion njihet kur OEK ka një obligim aktual si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, dhe është e mundur se një rrjedhje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer obligimin, dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së obligimeve. Provizionet rishikohen në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe rregullohen për të paraqitur parashikimin më të mirë. Kur efekti kohorë i vlerës së parave është material, shuma e provisionit është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohej për të shlyer obligimin.

2.16 Zotimet dhe kontingjencat

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveç nëse një rrjedhje e mundshme e burimeve që materializojnë përfitimet ekonomike është e largët. Asetet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur një rrjedhje e beneficioneve ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provizion nëse ka gjasa që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, detyrimin e pësuar në datën e bilancit dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

2.17 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përbëhen nga aksionarët dhe pronarët e Kompanisë, bashkë me njësitë që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të madhe mbi veprimet dhe menaxhmentin e Kompanisë. Kur konsiderohet çdo palë ndërlidhëse e mundshme, vëmendje i kushtohet substancës së marrëdhënies e jo vetëm formës ligjore.

2.18 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas fundvitit që japin informacione shtesë në lidhje me pozicionin e OEK në datën e Pasqyrës së pozitës financiare (ngjarjet rregulluese), duhet reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas fundvitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë të shpalosura në shënime, kur janë materiale.

3 Vlerësime dhe supozime të rëndësishme kontabël

Në aplikimin e politikave kontabël të OEK-ut, të cilat janë përshkruar në Shënimin 2, nga menaxhimi është e nevojshme të bëhen gjykime, vlerësime dhe supozime rreth vlerave kontabël të aktiveve dhe pasiveve që nuk janë lehtë të dukshme nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse rishikimi ndikon si në periudhën aktuale dhe të ardhshme.

Pasiguria në gjykime

Dëmtimi i aseteve jo-financiare

Humbjet nga dëmtimet njihen në shumën për të cilën vlera bartëse e asetit ose njësi për gjenerimin e parasë tejkalon shumën e rikuperueshme. Gjatë përcaktimit të shumës së rikuperueshme, menaxhmenti vlerëson çmimet e pritura dhe rrjedhën e parasë nga njësi për gjenerimin e parasë dhe përcakton një normë të interesit të duhur gjatë llogaritjes së vlerës aktuale të rrjedhës së tillë të parasë.

Dëmtimi i të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera

Organizata llogaritë dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera bazuar në bilancin e humbjeve të vlerësuara dhe eksperiencën historike të shlyerjes, vlefshmërinë-kreditore të klientit dhe ndryshimet në kushtet e pagesës së klientit gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së humbjes në zhvlerësim për llogaritë e dyshimta. Këto përfshijnë supozime lidhur me sjelljen e klientit në të ardhmen dhe vazhdimësinë e rrjedhës së parasë në të ardhmen. Nëse gjendja financiare e klientëve do të ishte për tu refuzuar, shlyerjet aktuale të të arkëtueshmeve aktualisht që ekzistojnë mund të jenë më të larta se që pritet dhe mund të tejkalojnë nivelin e deritanishëm të njohur të humbjeve në dëmtime të njohura deri tan.

Jetëgjatësia e aseteve të amortizueshme

Menaxhimenti rregullisht shqyrton jetët e dobishme të aseteve të amortizueshme, si në pasqyrën e pozicionit financiar. Menaxhimi vlerëson se jeta e përcaktuar e dobishme të aseteve përbën dobinë e pritshme (shërbimeve) të aseteve. Vlerat kontabël të aseteve të tilla janë analizuar në Shënimin 5. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të gabimeve teknike.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

4 Menaxhimi i riskut financiar**4.1 Faktoret e riskut financiar**

Aktivitetet e OEK-ut ekspozojnë atë ndaj një llojshmërie të risqeve financiare, duke përfshirë riskun kreditor dhe risket që lidhen me ndikimet e ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i riskut i OEK-ut fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe tenton të minimizojë efektet negative mbi performancën e biznesit të OEK-ut.

Menaxhimi i riskut bartet nga Menaxhmenti i OEK-ut në bazë të disa politikave dhe procedurave të aprovuara më herët që mbulojnë menaxhimin e riskut të përgjithshëm, si dhe fusha të veçanta si risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit, risku kreditor, masat e nevojshme për përdorimin e letrave me vlerë dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

4.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të OEK-ut nëse një klient apo palë dështon në përmbushjen e kushteve kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet tregtare të OEK dhe në parane dhe ekuivalentët e parasë.

OEK nuk ka koncentrim të rëndësishëm në riskun kreditor. Kompania ka politika që sigurojnë që shitja e mallrave dhe shërbimeve bëhet tek klientët me një histori të përshtatshme kreditore.

Risku kreditor për parane dhe ekuivalentën e saj konsiderohet i papërfillshëm pasi që palët korresponduese janë banka me reputacion.

Ekspozimi maksimal i OEK-ut ndaj riskut kreditor përfaqësohet nga shuma bartëse e secilit aset financiar në pasqyrën e pozicionit financiar, siç është shprehur në tabelën në vijim:

	2015	2014
Llojet e aseteve financiare – shumat bartëse:		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	128	114
Të arkëtueshmet tregtare, neto	-	14
	128	128

Cilësia e kreditit e të arkëtueshmeve tregtare të Kompanisë është e shpalosur në Shënimin 6.

4.3 Risku i likuiditetit

Kujdesi i menaxhimit të rrezikut për likuiditetin nënkupton mirëmbajtjen parave të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve përmes objekteve adekuate kreditit dhe aftësinë për të mbledhur në kohë, brenda afateve të përcaktuara në shumat nga konsumatorët. Për shkak të natyrës dinamike të OEK-ut, menaxhimi synon të ruajë fondet fleksibile, duke respektuar linjat përkushtuar kreditit në dispozicion.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare të OEK-ut. Tabelat përgatiten në bazë të rrjedhës së pazbritur të parasë së detyrimeve financiare.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2015				Gjithsej (në '000 Euro)
	Qarkulluese Deri në 1 vit (në '000 Euro)	1 deri 2 vite (në '000 Euro)	2 deri 5 vite (në '000 Euro)	Jo-qarkulluese Mbi 5 vite (në '000 Euro)	
Asetet financiare					
Të arkëtueshmet tregtare	-	-	-	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj	128	-	-	-	128
	128	-	-	-	128
Detyrimet financiare					
Të pagueshmet tregtare	65	-	-	-	65
Huatë	8	5	-	-	13
	73	5	-	-	78
Neto	55	(5)	-	-	50

	Më 31 dhjetor 2014				Gjithsej (në '000 Euro)
	Qarkulluese Deri në 1 vit (në '000 Euro)	1 deri 2 vite (në '000 Euro)	2 deri 5 vite (në '000 Euro)	Jo-qarkulluese Mbi 5 vite (në '000 Euro)	
Asetet financiare					
Të arkëtueshmet tregtare	14	-	-	-	14
Paraja dhe ekuivalentët e saj	114	-	-	-	114
	128	-	-	-	128
Detyrimet financiare					
Të pagueshmet tregtare	100	-	-	-	100
Huatë	7	13	-	-	120
	107	13	-	-	120
Neto	21	(13)	-	-	8

4.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshon në çmimet e tregut, siç janë normat e këmbimit të huaj dhe normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e OEK-ut ose vlerën e pronave të saj të instrumenteve financiare. Objektiva e menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin e riskut tregtarë përbrenda parametrave të pranueshëm, përderisa optimizon për kthim.

Foreign exchange risk

Në tërësi, OEK nuk i ekspozohet riskut të kursit të këmbimit sepse:

- Të hyrat njihen në Euro
- Blerjet e aseteve kryesore dhe materialeve të përdorura në aktivitetet e javës janë të shprehura në Euro.

Rrjedha e parasë dhe risku i normës së interesit të vlerës së drejtë

OEK ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet ekzistuese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë. Menaxhmenti i OEK-ut është kryesisht përgjegjës për monitorim të përditshëm të riskut neto të pozitës së normës së interesit dhe cakton limite për të zvogëluar potencialin e mospërputhjeve të mundshme të normave të interesit. Nuk ka përqendrim të veçantë të fondeve që bartin interes pasi që huatë janë nga institucionet financiare dhe subjektet me interes të ndryshueshëm në pasqyrën e pozicionit financiar. Luhatjet në normat e interesit të tregut nuk mund të kenë efekte negative mbi performancën financiare të OEK-ut. Në të njëjtën kohë, OEK-u nuk ka vendosje të veçantë të aseteve të saj në depozita të afatizuara dhe letra me vlerë me likuiditet të lartë, që bartin të ardhura shtesë të interesit.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

Risku i tregut (vazhdim)	2015	2014
Asetet financiare		
<i>Që nuk bartin interes</i>		
Të arkëtueshmet tregtare, neto	-	14
Paraja dhe ekuivalentët e saj	128	114
	128	128
Detyrimet financiare		
<i>Me normë fikse të interesit</i>		
Huatë	13	20
<i>Që nuk bartin interes</i>		
Të pagueshmet tregtare	65	100
	78	120

4.5 Instrumentet financiare sipas kategorive

Vlera kontabël e aseteve dhe detyrimeve financiare të OEK-ut njihet në pasqyrën e pozicionit financiar të periudhave raportuese në shqyrtim dhe mund të kategorizohen si më poshtë:

	2015	2014
Huatë dhe të arkëtueshmet		
Huatë dhe të arkëtueshmet,neto	-	14
Paraja dhe ekuivalentët e saj	128	114
	128	128
Detyrimet financiare me kosto të arnotizuar		
Huatë	13	20
Të pagueshmet tregtare	65	100
	78	120

4.6 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë paraqet çmimin që do të arkëtohej me shitjen e një aseti apo që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt mes pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

4.6.1 Instrumentet financiare të njohura në vlerë të drejtë

Asetet financiare të matura me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozitës financiare në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki grupon asetet dhe detyrimet duke u bazuar në rëndësinë e të dhënave pasuese të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aseteve financiare si në vijim:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për asete dhe detyrime identike;
- **Niveli 2:** të dhëna të tjera pasuese, përveç çmimeve të kuotuar, të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë të gatshme për vëzhgim të asetit ose detyrimit, direkt (p.sh si çmime), ose indirekt (p.sh të bëra nga çmimet) dhe
- **Niveli 3:** të dhënat pasuese në asete ose detyrime që nuk janë të bazuara në të dhëna të gatshme për vëzhgim tregu.

OEK-u nuk ka asete financiare të matura me vlerë të drejtë në datën e pasqyrës së pozitës financiare.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

4.6.2 Instrumentet financiare që nuk janë paraqitur në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledhë shumat bartëse dhe vlerat e drejta për ato asete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2015	2014	2014	2014
Asetet				
Të arkëtueshmet tregtare, neto	-	14	-	14
Paraja dhe ekuivalentët e saj	128	114	128	114
Gjithsej asetet	128	128	128	128
Detyrimet				
Huatë	13	20	13	20
Të pagueshmet tregtare	65	100	65	100
Gjithsej detyrimet	78	120	78	120

Vlera bartëse e të pagueshmeve tregtare dhe të tjera i përafrohet vlerës së tyre të drejtë përshkak të maturitetit të tyre afatshkurtë.

4.6.3 Matja e vlerës së drejtë e aseteve jo-financiare

Siç është shpalosur në Shënimin 2.4 dhe më tej në Shënimin 5, ndërtesat OEK-ut janë bartur në rivlerësimin e tyre, në bazë të vlerësimit jo-përsëritës të kryer nga vlerësues të pavarur të autorizuar. Inputet e përdorura në vlerësimin ishin të dukshme në mënyrë të drejtpërdrejtë (të tilla si çmimet) ose tërthorazi (rrjedh nga çmimet), në lidhje me nivelin 2 në përputhje me SNRF 13.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

5 Prona, pajisjet dhe impiantët

	Ndërtesa	Pajisjet e TI	Pajisje për zyrë	Makinat	Gjithsej
Kosto					
Më 01 janar 2014	1,527	60	46	94	1,727
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-	-
Shlyerja	-	(25)	-	-	(25)
Efekti I rivlerësimit	(427)	-	-	-	(427)
Më 31 dhjetor 2014	1,100	35	46	94	1,275
Më 01 janar 2015	1,100	35	46	94	1,275
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2015	1,100	35	46	94	1,275
Zhvlerësimi i akumuluar					
Më 01 janar 2014	433	33	44	61	571
Shpenzimet e zhvlerësimit gjatë vitit	76	2	2	21	101
Efekti I rivlerësimit	(509)	-	-	-	(509)
Më 31 dhjetor 2014	-	35	46	82	163
Më 01 janar 2015	-	35	46	82	163
Shpenzimet e zhvlerësimit gjatë vitit	37	-	-	12	49
Më 31 dhjetor 2015	37	35	46	94	212
Vlera neto bartëse					
Më 31 dhjetor 2014	1,100	-	-	12	1,112
Më 31 dhjetor 2015	1,063	-	-	-	1,063

Rivlerësimi i ndërtesave

Më 31 dhjetor 2014, OEK-u ka rivlerësuar ndërtesat e saj. Shumat e rivlerësuar përcaktohen në bazë të rivlerësimit të kryer nga vlerësues të pavarur profesional. Efekti i rivlerësimit, duke qenë diferenca midis vlerave kontabël të ndërtesave llogariten në datën e vlerësimit dhe shumës së rivlerësuar, në shumën prej 82 mijë Euro njihet si rezerva rivlerësimi në kuadër të pasqyrës së ndryshimve të fondeve.

6 Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

	2015	2014
Të arkëtueshmet tregtare		
Të arkëtueshmet tregtare vendore	224	161
	224	161
Provizioni për zhvlerësim	(224)	(147)
	-	14
Të arkëtueshme tjera		
Avanset e dhëna tek punëtorët	-	38
	-	38
	-	52

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera (vazhdim)

Struktura e vjetërsisë së të arkëtueshmeve tregtare të OEK më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është si në vijim:

	2015	2014
Të vonuara por jo të zhvlerësuara:		
- Deri në 1 muaj	-	-
-1 deri në 3 muaj	-	-
- 3 deri në 6 muaj	-	-
- 6 deri në 12 muaj	19	14
- Mbi 12 muaj	205	147
	224	161
Minus: Provizioni për zhvlerësim	(224)	(147)
	-	14

Levizjet e provizionit për dëmtimet e të arkëtueshmeve tregtare është si në vijim:

	2015	2014
Më 1 janar	147	98
Ngarkesa për vitin	77	49
Më 31 dhjetor	224	147

7 Paraja dhe ekuivalentët e saj

	2015	2014
Llogaritë qarkulluese me bankat vendore	128	114
Paraja e gatshme	-	-
	128	114

8 Huatë

	2015	2014
Huatë afatgjata që bartin interes		
Raiffeisen Leasing (19 mijë Euro; 10.9%, 60 muaj)	5	9
Raiffeisen Leasing (16 mijë Euro; 10.9 %; 60 muaj)	8	11
	13	20
Minus: maturiteti aktual	(8)	(7)
Huatë afatgjata që bartin interes	5	13
Huatë afatshkurta që bartin interes		
Raiffeisen Leasing (19 mijë Euro; 10.9%, 60 muaj)	5	4
Raiffeisen Leasing (16 mijë Euro; 10.9 %; 60 muaj)	3	3
Huatë afatshkurta që bartin interes	8	7
Gjithsej huatë	13	20

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

9 Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

	2015	2014
Kreditorët tregtarë		
Furnizuesit vendor	65	100
	65	100
Të pagueshmet tjera qarkulluese		
Tatimi mbi të hyra personale	8	3
Kontributi pensional	5	4
Pagat neto	-	38
	13	45
	78	145

10 Të ardhurat nga shërbimet dhe aktivitetet

	2015	2014
Të hyrat nga panaiet e tregëtisë	275	89
Të hyrat nga trajnimet	157	-
Të hyrat nga qiraja	97	66
Të hyrat nga shërbimet e arbitrazhit	24	33
Të hyrat nga shërbimet e mallrave me origjinë	10	16
Të hyrat nga shërbimet barcode	2	12
Të hyrat nga projektet	-	112
Të hyrat tjera	57	310
	622	638

11 Të ardhurat nga grantet

	2015	2014
Grantet nga USAID	82	34
Ambasada Britaneze	1	-
Grantet nga GTZ	-	30
	83	64

12 Shpenzimet e stafit

	2015	2014
Pagat	336	324
Kontributet pensionale	17	15
	353	339

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

13 Shpenzimet operative

	2015	2014
Shpenzimet për konculencë	120	128
Humbjet nga lejjimet e llogarive të arkëtueshme	77	49
Shpenzimet e udhëtimit	59	71
Shpenzimet e projektit	46	135
Shpenzimet e panairëve	35	-
Shpenzimet e trajnimeve	19	8
Shpenzimet e arbitrazhit	18	16
Furnizim për zyre	17	11
Interneti dhe telefoni	15	15
Shpenzimet gjyqësore	14	-
Reprezentacion	13	18
Shpenzimet e anëtarësimit	10	5
Shpenzimet e derivateve	9	15
Shpenzimet bankare	6	3
Shpenzimet komunale	4	12
Mirëmbajtja e veturave	4	2
Marketingu	2	10
Shpenzimet e sigurimit	2	9
Mirëmbajtja	1	9
Qiraja	1	2
Taksa komunale	1	1
Shlyerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	-	25
Shpenzime tjera	18	42
	491	586

14 Zotimet dhe kontigjencat

Çështjet ligjore

OEK, është e përfshirë në procedura ligjore të ngritura nga punëtorët e saj dhe entitete tjera ligjore. Më 31 dhjetor 2015 dhe më pas, deri në datë e pasqyrës së pozicionit financiar janë çështje në gjykata në total prej 19 mijë Euro, për të cilat OEK nuk ka njohur provizione.

Detyrimet tatimore

Librat tatimor të OEK për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore vendore. OEK ka ndjekur të gjitha rregullat dhe rregulloret e tatimit gjatë kalkulimit të detyrimeve të tatimit, sidoqoftë interpretimet e tatimit sipas autoriteteve tatimore mund të ndryshojnë nga ato të përdorura nga OEK.

Zotimet kapitale

There are no significant capital commitments as at 31 December 2015 and 2014 not already recognised in these financial statements.

15 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Një palë është e lidhur me një entitet, direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollon nga, ose është nën kontroll të përbashkët me entitetin, pala ka një interes në entitet që i jep ndikim të rëndësishëm mbi entitet, pala ka kontroll të përbashkët mbi entitetin, pala është pjesëmarrës ose pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të entitetit, ose prindit të tij.

Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015
 (Të gjitha shumat janë të paraqitura në mija Euro, përveç nëse është e cekur ndryshe)

Transaksionet me palët e ndërlidhura (vazhdim)

OEK ka transaksione me palët e ndërlidhura gjatë rrjedhës normale të aktiviteteve biznesore.

	Të arkëtueshme	Detyrime	Të hyra	Kosto
31 dhjetor 2015				
Përfitimet afatshkurtëra të menaxhmentit	-	-	-	40
	-	-	-	40
<hr/>				
	Të arkëtueshme	Detyrime	Të hyra	Kosto
31 dhjetor 2014				
Përfitimet afatshkurtëra të menaxhmentit	-	-	-	43
	-	-	-	43
<hr/>				

16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Pas 31 dhjetorit 2015 – datës së raportimit deri në aprovimin e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka axhustime në pasqyrat financiare apo ngjarje materiale që mund të kërkojnë shpalosje në këto pasqyra financiare.



Grant Thornton

www.grantthornton-ks.com